



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË VEÇANTË TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 6 MARS 2019**

**SA POSEBNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 6. MARTA 2019. GODINE**

**MARS - MART
2019**

Rendi i ditës

1. Shënimi i 21-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Dnevni red

1. Obeležavanje 21-godišnjice Epopeje Oslobodilačke Vojske Kosova

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
E nderuar Familje e Komandantit Legjendar Adem Jashari,
I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare,
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të misionëve diplomatike në Kosovë,
Të nderuar zonja dhe zotërinj të pranishëm,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
E hap seancën e veçantë të Kuvendi të Republikës së Kosovës në nderim të Epopesë së Ushtrisë
Çlirimtare të Kosovës.

Të nderuar të pranishëm,
Para se të fillojmë me adresimin në këtë seancë, ju ftoj për një minutë nderim në kujtim të të
rënëve.

(Një minutë heshtje)

Lavdi!

E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, për një fjalë rasti.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Kadri Veseli,
Nënkryetarë të Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
E nderuar dhe shumë e respektuar Familje Jashari,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Kor diplomatik,
Të nderuar të pranishëm,
Qytetarë të Kosovës,
Bashkëkombës shqiptarë kudo që jeni,
Në fillim më lejoni të shpreh falënderimin për ju sot, për mbajtjen e kësaj seance solemne
kushtuar sakrificës sublime të heroit tonë, Komandanti tonë Legjendar - Adem Jasharit dhe
Familjes Jashari. Njëkohësisht shpreh falënderim për gjithë nderimin që bëjnë qytetarët e
Kosovës anekënd atdheut, bashkëkombësit tanë kudo që janë, dhe të gjitha institucionet e vendit.

Sot ne e përkujtojmë me respekt sakrificën sublime dhe përulemi para veprës dhe varreve ku
pushon Komandanti Legjendar, Adem Jashari dhe Familja e Tij, dhe themi URIME për

ringjallje, sepse në marsin e '98-tës, një familje u shua, në mënyrë që të ringjallet një popull i robëruar dhe në gjirin e tij u rikthye sërish Familja Jashari.

Në Prekaz, falë sakrificës supreme dhe të paarritshme për liri të Jasharëve ka ndodhur kthesa historike. Sakrificë e paarritshme në madhësinë e saj, që ia rriti zërin thirrjes së shqiptarit të shkelur në përmasa botërore. Jasharët e dhanë krejt çka kishin të tyren për ne dhe për atë ç'është e jona sot.

Adem Jashari ishte zemra e orës shqiptare që lëvizi përpara akrepat e historisë, duke i ndryshuar epokat.

Kur mbi Kosovën ra muzgu ai zgjoi agun, se ai zgjohej kur të tjerë binin. Kur disa kërkonin shtigje - ai çelte rrugë.

Prandaj sot, të gjithë ne, liderë institucionalë dhe opozitarë, siç ishim bashkë dje në përpjekjet për liri, siç jemi bashkë sot në kujtesë të Epopesë së Jasharëve, duhet të bashkohemi nesër e kurdo për të drejtën tonë, sepse ia kemi borxh atdheut, ia kemi borxh Kryekomandantit.

Falë Komandantit Legjendar dhe Familjes Jashari, pas mijëra vjetëve histori, Kosova i ka miqtë e përjetshëm, ka SHBA-të dhe aleatët, por e ka edhe rreshtin e vet, ushtrinë e mandatuar nga Ju, deputetë të nderuar.

Kosova ka sot më shumë siguri dhe liri për vete. Kosova sot i bën të ndihen të lirë të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Kosova sot u bëhet krah ushtrive dhe popujve për të ndihmuar lirinë dhe paqen në botë.

Lavdi e përjetshme Jasharëve dhe të gjithë brezave të luftëtarëve shqiptarë që ranë për liri!
Lavdi!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryeministër!

Të nderuar të pranishëm,

Më lejoni që në nderim të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të ju drejtohem me një fjalë rasti:

E nderuar Familje Jashari,

I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues diplomatikë nga vendet mike të akredituara në Republikën e Kosovës,

I nderuar komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës, i Ushtrisë së Kosovës,

Drejtor i Policisë,
Të nderuar zonja dhe zotërinj,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Janë disa ngjarje që e bartin peshën e ndërrimit të epokave.

Ato shënojnë ndarjen e së tashmes prej të së shkuarës, duke hapur shtigje të reja nëpër të cilat ecin popujt dhe shtetet.

Një peshë të tillë e ka 5 marsi i vitit 1998.

Atë ditë në Prekaz po ndryshonte historia e kombit tonë.

Kosova po e niste rrugën pa kthim drejt lirisë dhe pa dyshim simboli më unik i kësaj rruge ishte Adem Jashari dhe familja e tij martire.

Lufta dhe rënia e tyre, sakrificat e tyre e pashembullt në historinë njerëzore, e vulosën përcaktimin e popullit tonë në luftën për liri.

Adem Jashari dhe familja e tij ranë që kombi ynë të ngrihej në këmbë.

Dhe, ne u ngritëm!

I madh e i vogël, burra e gra, nga i gjithë kombi.

U bashkuam nën emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe e bëmë realitet ëndrrën për të cilën ra Adem Jashari dhe mijëra dëshmorë të lirisë.

Në fundin e shekullit XX, Kosova hyri në hartën e vendeve të lira dhe aty do të qëndrojë përgjithmonë.

Ky është zotimi ynë i madh për gjeneratat e reja që do ta trashëgojnë këtë vend të bekuar nga Zoti dhe njerëzit e mirë, Atdheu ynë, Republika e Kosovës.

Zonja dhe zotërinj,

Sot, në këtë ditë të madhe, ne përkulemi me respekt para kujtimit të të gjithë brezave që sakrifikuan për Kosovën e lirë, shtet të pavarur e sovran.

Nderimi për ta jeton në mendjet dhe zemrat tona do të jetë sot dhe përgjithmonë.

Nëpërmjet emrave të tyre sot ne e definojnë dashurinë për Atdheun tonë, Kosovën tonë të lirë e sovranë.

Por, ky nderim është vetëm njëri dimension i kësaj dite të madhe.

Dimensioni tjetër është zotimi ynë për të vazhduar misionin e gjeneratës sonë, misionin e fuqizimit të Kosovës në çdo fushë të ekzistencës së saj si shtet dhe shoqëri.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Këtë vit, ne e kremtojmë 20-vjetorin e çlirimit.

Si gjeneratë, jemi të veçantë që e patëm fatin të bashkëjetojmë në kohën e kolosëve të kombit tonë, si Adem Jashari, Zahir Pajaziti, Fehmi e Xhevë Lladrovci, Luan Haradinaj, Bekim Berisha, Xhevat Jusufi, Agim Ramadani, Avdullah Tahiri, Ahmet Kaçiku, Mujë Krasniqi e shumë e shumë të tjerë.

Dhe, së bashku, si komb, e arritëm lirinë.

Sa gjëra të mëdha kemi arritur në këto dy dekada!

Nga një vend krejtësisht i shkatërruar, me plagë të mëdha të luftës, në pak vite e rindërtuam jetën tonë si shoqëri, ndërtuam institucionet demokratike, shpallëm pavarësinë dhe e formuam shtetin dhe vitin që shkoi edhe forcën tonë mbrojtëse - Ushtrinë e Kosovës.

Diçka që të tjerëve u janë dashur shumë dekada për t'i arritur, ne i kemi arritur vetëm për dy dekada.

Disa gjëra kemi mundur t'i bëjmë ndryshe, kemi mundur t'i bëjmë më mirë. Por, jam i bindur se gjeneratat e së ardhmes kanë për t'u ndjerë krenare me punën tonë.

Po, ku qëndron çelësi i kësaj historie madhështore suksesi?

Janë njerëzit e këtij vendi, që në luftë dhe në paqe nuk kursyen asgjë nga vetja për ta ngritur në këmbë Kosovën, për t'ia kthyer dinjitetin dhe për ta bërë këtë vend të shpresës për fëmijët dhe të rinjtë e vet.

Janë edhe miqtë tanë të mëdhenj, të cilët qëndruan pranë nesh në çdo sfidë gjatë këtyre viteve. Janë shtetet demokratike, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që udhëtuan bashkë me ne në të gjitha proceset e mëdha të kombit tonë.

Lirinë e kemi arritur me vendosmëri dhe me mençuri. Ishim të patundur në luftë me armikun dhe partnerë me ata që na u ndodhën pranë - miqtë e lirisë sonë - NATO-n dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kohëve të fundit jemi dëshmitarë se janë hapur dilema e janë shtruar pikëpyetje për të ardhmen e këtij partneriteti.

Sot, është dita t'i heqim këto dilema dhe t'i bëjmë të pakuptimta këto pikëpyetje.

Miqësia jonë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, aleanca jonë me botën perëndimore, janë vlera të shenjta të kombit tonë.

Prandaj, janë të paprekshme, të pacenueshme.

Janë të përgjithmonshme.

Si vetë liria jonë, për të cilën ranë Jasharët e Prekazit dhe mijëra dëshmorë të tjerë.

Ky është identiteti ynë civilizues, nga i cili nuk mund të heqim dorë, sepse kombet nuk mund të tjetërsohen.

Sot, në këtë ditë të madhe, në ditën e Adem Jasharit, duhet dy gjëra t'ua bëjmë të qartë qytetarëve dhe vetes, sidomos vetes tonë si politikanë, si përfaqësues të zgjedhur të popullit:

Interesi i shtetit është mbi çdo interes tjetër. Kosova nuk do të kthehet pas. Kosova veç do të ecën përpara dhe do të fuqizohet.

E kemi amanet nga dëshmorët dhe zotim për të ardhmen e fëmijëve të saj.

Lavdi jetës dhe veprës heroike të Komandantit Legjendar, Adem Jasharit!

Lavdi gjithë heronjve të rënë të kombit tonë në luftën për liri! Faleminderit!

Të nderuar të pranishëm,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ju falënderoj dhe me këtë i përmbyll punimet e seancës e seancës së veçantë në nderim të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*